



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration

K O N K U R S

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

Titulli i vendit të punës:

I. Udhëheqës Ekzekutiv në:
Sekretariatit e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (1).

Paga mujore: 1.126.13 € bruto.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Kryetarin e Këshillit; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Sekretariatit të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Sekretariatit të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Sekretariatit; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Sekretariatit; menaxhon rrjedhën e informacionit në Sekretariat dhe koordinon raportet e Sekretariatit me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përshkrimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësiave të punës për këtë pozitë mund të gjeni në linkun <http://map.rks.gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfe3/.aspx>

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

- Konkurrimi për pozitën e Udhëheqës Ekzekutiv është e hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e preferuar në fushën e trashëgimisë kulturore, arkitekturës, arkeologjisë, etnologjisë apo histori të artit.

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; njohuri bazike në programet e kompjuterit; standarde të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njoftohen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përzgjedhjes do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Përzgjedhja e Udhëheqës Ekzekutiv bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati për pozitën e Udhëheqës Ekzekutiv është 3 vjet.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.ks-gov.net>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për veprë penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Aplikantët duhet të paraqesin CV-në dhe letër motivimin me shpjegim të qartë dhe me shembuj nga përvoja profesionale në fushën e planifikimit strategjik, mendimit kreativ, aftësia për zgjidhjen e problemeve, orientim drejt rezultateve, lidërshiptit, menaxhimit, bashkëpunimit kolegjial, përshtatja me ambientin e punës dhe ndërjegjshmëria në punë, se si përvoja dhe shkathtësitë përputhen me kërkesat e vendit të punës.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t’i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 – 16:00.